

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) dru Kodi sipas FPP- 03410000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 787 720 (dy milion e shtateqind e tetedhjetë e shtatë mijë e shtateqind e njezet) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3;*
- c. *Formulari i ofertes sipas shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhës te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40% e vleres së përlloritur të kontratës që prokurohet. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c dhe neni 55, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe në pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe bazuar ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitetet për 6-mujorin e I (pare) te v.2023, (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

(Per plotesimin e kriterit te mesiperm, eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin).

Pika 2.2.2 konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit plotësojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, si dhe nenit 41, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri i pikës 2.2.3 u vendos në referencë te nenit 76, pika 2 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe u vleresuan të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe konkretisht në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Megjense operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates, ne nje vlere jo me te madhe se 20% te vleres se perlloragitur te kontrates qe prokurohet (neni 55/4/b i vkm-se 285/2021)

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4 b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatëtri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton **origjinën e mallit:** (OE duhet të plotësojë minimalisht njerin nga kushtet e mëposhtme)

- a. Ofertuesit duhet të paraqesin kontratën e furnizimit me dru nga subjekti shitës Bashki/Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe fakturën tatimore të shitjes. ose kontrate furnizimi me keta të fundit shoqëruar me dokumentacionin e mesipër (kontrate furnizimi, leje shfrytëzimi dhe fatura tatimore shitjet Bashki/Koncesionar) si dhe fakturën tatimore të blerjes. (sipas vkm 438 date 08.06.2016).
- b. Nëse ofertuesit janë importues të druve të zjarrit nga jashtë duhet të paraqesin deklaratën doganore. Nëse nuk janë importues do të paraqesin kontrate furnizimi me importuesit shoqëruar dhe me fakturën tatimore të blerjes, kjo në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyrë të garantohet realizimi me sukses i kontratës

Argumentim: Ky kriter u vendos në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 57/2020”Për pyjet” dhe VKM nr.438 date 08.06.2016”Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore”

Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës me korrektesi gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij periodik në tregtimin e lëndës drusore zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi duke justifikuar me dokumentacion ligjor origjinen e mallit objekt prokurimi .

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **1(nje) automjet transporti** jo me pak se 3.5 ton (në pronësi ose me qera), të pershtatshme për transportin e druve.

-Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikate pronësie, çertifikata e kontrollit teknik, policen e sigurimit të mjetit si dhe çertifikata e transportit e vlefshme.

-Për mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet afati i kontratës që duhet të përfshijë gjithë periudhën e furnizimit, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, policen e sigurimit të mjetit si dhe çertifikata e transportit e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ç.) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshtë kërkuar që ofertuesi të disponojë 1(nje) automjet transporti jo me pak se 3.5 ton për të realizuar furnizimin me dru në zonat periferike ndërsa automjetet mbi 1.5 tone për të realizuar furnizimin me dru në zonat e thella malore .

2.3.4 Ofertuesit duhet të paraqesin dokumentacion të rregullt që subjekti i tyre është kontrolluar nga Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe Territorit dhe se nga kontrolli, subjekti ka rezultuar konform legjislacionit në fuqi.

2.3.5 Për arsye se furnizimi mund të jete ditor dhe në orare të ndryshme për të gjithë institucionet e varesise sipas grafikut si dhe shtrirjes gjeografike të këtyre institucioneve, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës **te kenë të depozituar në territorin që ushtrojnë aktivitetin mallin e kërkuar**. Për këto pike Operatori ekonomik ofertues duhet të **deklarojë vendodhjen**

e mallit te shoqeruar me ambjente magazinimi dhe **deklarimin e gjendjes aktuale te mallit** qe kerkohet, ne menyre qe te verifikohet nga Autoriteti Kontraktor.

- 2.3.6** Vertetim per numrin mesatar te punonjesve per muajin e fundit i cili te jete jo me i vogel se 2 (dy) punonjes, leshuar nga organet tatimore te shoqeruara dhe me listpagesat perkatese.
Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 8 te DT. Dokumentat e kerkuara me sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

(Per plotesimin e kriterit te mesiperm eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet qe "Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j", te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurrohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kerkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kerkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur permendet "marke" perfshihet termi "ekuivalent".

Sqarim per ofertuesit: Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 " Per Prokurimin Publik "** neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te

prokurimit publik”,neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, date 19.05.2021.

Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Skicimet, parametrat teknik etj:

SPECIFIKIMET TEKNIKE “Blerje dru zjarri”

- Cmimet e druve duhet të jenë të **shprehura në mst pa tvsh duke u kryer konvertimet e nevojshme në matjet gjate furnizimit në masat e furnizimit.**
- Drute të jenë të prera dhe të çara
- Gjatesia e prerjes për konsum të jetë jo më e madhe se 30 deri në 35 cm
- Trashësia e seksionit rrethore nga 15 – 20 cm
- Drute të jenë lisi ose ahu të thata.
- Te mos ketë dru të kalbura gjate furnizimit .
- Transporti do të behet nga shitesi deri në objektet që janë nën juridiksionin e bleresit (sipas grafikut të shpërndarjes) duke qenë e mundur matja e volumit të mallit nga bleresi.
- Malli do të behet hyrje kur pritesit e mallit në objekt të jenë dakort për cilësinë dhe sasinë e mallit.

- Sasia e mallit që do të blihet (dru zjarri) është **520 mst**
- Afatet e lëvrimin të lëndës drusore do të jetë mujor (ditor në varesi të situatave), sipas sasive mujore të përcaktuara në planin e shpërndarjes për çdo institucion arsimor në varësi të Bashkisë Mirditë

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Drute duhet të dorezohen në çdo objekt (*shkolla, kopshte dhe çerdhe*) sipas Njesive Administrative të Bashkisë Mirditë, dhe të sistemohen me qëllim matjen e tyre.
- Drute duhet të jenë të stivosura në objekt nga OE dhe do të merren në dorezim sipas grafikut të nënshkruar midis operatorit ekonomik dhe AK-se, brenda orarit zyrtar të punës dhe jo në ditë pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do të bëhet nga kontraktuesi me automjetet e tij nga pika e furnizimit deri në destinacion sipas grafikut të levrimit mallit.
- Në rast se malli objekt prokurimi (dru zjarri) nuk plotëson kërkesat dhe standartet teknike, nuk do të merret në dorezim.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT